



Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	Palëse - Izlazni Outgoing No.Nr. 02 074-23 20.04.2023
---	---

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

Në bazë të paragrafit 6 te nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) lidhur me paragafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimit Publik, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 16.04.2023 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “GJEO-PROJEKT” SH.P.K. nga Prishtina, bie këtë :

VENDIM

I

Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “GJEO-PROJEKT” SH.P.K nga Rahoveci e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 16.04.2023 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-23-991-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-002-2-2-1 me titull: Shërbime për matjet kadastrale në Mamushë

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “GJEO-PROJEKT” SH.P.K nga Rahoveci me datën 16.04.2023 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendirnit për anulim të procedurës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: Shërbime për matjet kadastrale në Mamushë

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë i kemi paraparë kërkesat të cilat duhet ti plotësojnë Operatorët Ekonomik për të qenë të përgjegjshëm, andaj vlerësimi është bërë në bazë të legjislacionit të LPP-s si dhe në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6, 7; 56; dhe 59 të LPP-s si dhe neni 41.11, 41.12 dhe 18.4 të RuUOP. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s dhe rregullores (me ç'rast O.E. ju ka referuar rregullave dhe udhëzuesit të shfuqizuar), janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Pretendimi i O.E. që ne nuk kemi siguruar shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë të drejtë dhe efikase, duke shpenzuar mjete financiare në mënyrë jo të drejtë dhe se është shkelur neni 1 i LPP-s nuk qëndron, pasi që ne si Autoritet Kontraktues e kemi zhvilluar procedurën në fjalë duke u bazuar në dispozitat e nenit 1

si dhe në dispozitat tjera të LPP-s në mënyrë të hapur dhe transparente. Pra pretendimi nuk qëndron pasi që në tërsi janë respektuar dispozitat e këtij nenit. Do të vinte në shprehje shkelja e këtij nenit po që se O.E. ankues do të kishte dorëzuar tender të përgjegjshëm, në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, mirëpo me qenë se nuk i ka plotësuar kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë është konsideruar si O.E. i pa përgjegjshëm. Gjithashtu duke pasur parasysh për këtë kontratë nuk është rekomanduar për dhënie të kontratësasnje Operator Ekonomik, por është vendosur që të anulohet procedura e prokurimit, pasi që nuk kemi pranuar asnje ofertë të përgjegjshme dispozitat e këtij nenit nuk zbatohen për këtë rast.

Edhe nenit 6 është i ndërlidhur me nenit 1 pasi që procedura në fjalë është anuluar dhe nuk është shpërblyer me kontratë ndonje Operator Ekonomik i cili ka dorëzuar ofertën më të lartë se O.E. ankues, prandaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-s, edhe ky pretendim nuk qëndron pasi që procedura është zhvilluar në mënyrë të hapur dhe transparente. Vlerësimi është bërë në mënyrë profesionale duke i trajtuar të gjithë O.E. në mënyrë të barabartë. Operatori Ekonomik ankues këtu është thirrur sikur ne e kemi shpërblyer me kontratë ndonje pjesëmarrës në tender, mirëpo ne e kemi anuluar procedurën në fjalë për shkak se nuk kemi pranuar asnje ofertë të përgjegjshme andaj edhe pretendimi që është shkelur nenit 7 i LPP-s është i pa bazë.

Edhe pretendimi që është shkelur nenit 56 i LPP-s është i pa bazë pasi që në dispozitat e tij është paraparë që kontratat do të jepen sipas vlerësimit të tenderëve dhe kandidateve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2 të nenit 51dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të këruara në bazë të nenit 28 të këtij ligji. Operatori Ekonomik e ka pasur në dispozicion mundësin e kërkesës së informatave sqaruese nëse ka pasur ndonje paqartësi në lidhje me kriteret e vlerësimit si dhe me specifikacionin teknik, mirëpo nuk ka paraqitur një kërkesë të tillë, andaj konsiderojmë që pretendimi që janë shkelur dispozitat e nenit 56 nuk qëndron.

Edhe pretendimi se është shkelur nenit 59 i LPP-së, është i pa bazë dhe i pa qëndrueshëm, pasi që në dispozitat e këtij nenit në paragrafin 4 është paraparë që Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHE NAVE TË TENDERIT (FDT) në nenit 5.5 dhe në njoftimin për kontratë në nenit lili pika III.1.3 është paraqitur kushti si vijon:

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin për kryerjen e matjeve kadastrale sipas specifikave teknike të këruara në dosjen e tenderit.
- Afati i matjeve kadastrale nuk duhet të jetë më i gjatë se 10 (dhjetë) ditë nga data e marrjes së kërkesës nga Autoriteti Kontraktues.

Në rast të mos përbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Operatori Ekonomik me tenderin e tij nuk e ke dorëzuar afatin për matjet kadastrale sikur është cekur më lartë.

Gjithashtu në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FDT) neni 3.1 në pikën a. është paraqitur kushti si vijon:

Operatori ekonomik me tenderin e tij duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për furnizimet (materialet) e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (Të plotësohet, nënshkruhet dhe vuloset dhe dorëzohet aneksi nr. 7 i kësaj dosje të tenderit).

Duke u bazuar në nenin 10 paragrafin 10.1 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik nr. 001/2023, ne paraqiten tabelore është paraparë që në rast se mungon specifikacioni teknik, refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Sa i përket afatit për matjet kadastrale, kërkesa nga ana e AK-s ka qenë e qartë që për të qenë e vlefshme, oferta e Operatorëve Ekonomik janë të obliguar që të hartojnë afatin për kryerjen e matjeve kadastrale sipas specifikave teknike të kërkua e në dosjen e tenderit brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditë nga data e marrjes së kërkuesës nga Autoriteti Kontraktues dhe të njëjtin ta dorëzojnë me tenderin e tyre.

Operatori Ekonomik ankues në fjalë pretendon se afati për mbylljen e kontratës është 36 muaj dhe se është e pamundur të krijohen afate për kryerjen e matjeve kadastrale, sepse OE, nuk e dinë saktësish cili do te jetë volumi i punëve te cilat mund te përfshihen ne kërkese dhe se a mund te realizohet për 10 ditë, ai më tej potencon se siç e dimë edhe pas marrjes se kërkuesës nga AK, mund te paraqiten edhe kushtet e ndryshme te cilat ndikojnë që te mos realizohen matjet per 10 ditë. Duke pasur parasysh qe AK, ka kërkuar nga Operatoret Ekonomik qe te jene te licencuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe te ketë një gjeodet te licencuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, konsiderojmë që matjet gjeodezike duhen te realizohen konform Ligjit për Kadastër, Udhëzimeve Administrative dhe Kornizave te Punës, dhe afateve ligjore te cilat janë te cekura ne këto ligje, udhëzime administrative dhe korniza te punës ku edhe gjeodetet e licencuar dhe kompanitë gjeodete janë të obliguar ti respektojnë këto afate kohore, ne te kundërtën shkaku i shkeljeve mund ti revokohet licenca nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Si dhe konkludon që caktimi i afateve tjera per kryerjen e kërkuesave, do te ishte shkelje ligjore nga kompania gjeodete dhe nga gjeodeti i licencuar.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në nenin 16.1 është paraparë afati për sqarimin e tenderit i cili ka qenë deri me datën 06.03.2023 ora 14:00 në mënyrë që O.E. të kërkojnë sqarim në lidhje kushtet dhe kërkuesat e dosjes së tenderit, mirëpo ne nuk kemi pranuar ndonjë kërkessë për sqarimin e tenderit nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës, andaj ata janë pajtuar që të tenderojnë me kërkuesat dhe kriteret e parashtruara nga ne si Autoritet Kontraktues. Ndërsa nuk do mend se matjet duhet të bëhen sipas legjislativit për kadastrin por që kërkesa për të kryer një shërbim të porositur nga ana e AK-s ka qenë e qartë, pra brenda afatit prej 10 ditëve. Andaj konsiderojmë që pretendimi i O.E. ankues sa i përket kësaj pike është i pa bazë.

Sa i përket deklaratës që Operatorët Ekonomik ti përbahen specifikaciont teknik të paraqitur në aneksin nr. 1 të dosjes së tenderit është kërkuar që të plotësohet, nënshkruhet dhe vuloset aneksi nr. 7 i cili ka qenë i bashkangjitur me dosjen e tenderit. Kjo kërkessë nuk ka qenë si kërkessë e vendosur nga ndonjë dosje tjetër sikur pretendon O.E. ankues por është kërkuar nga O.E. që me tenderin e tyre të dorëzojnë edhe deklaratën se do ti kryejnë shërbimet sipas specifikave teknike të kërkua e në aneksin nr. 1 të dosjes së tenderit. Është e vërtetë që në vend të fjalës shërbim gabimisht është shkruar furnizim por që është ditur që kontrata në fjalë është kontratë për shërbime dhe se vetë titulli është cekur se do të bëhen

shërbime për matje kadastrale. Edhe sa i përket kësaj kërkesë O.E. ankues ka mundur që të paraqet kërkesë për të sqaruar kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit, mirëpo ne nuk kemi pranuar ndonjë kërkesë për sqarimin e tenderit nga Operatorët Ekonomik sa i përket pikës së lartëcekur. Andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Sa i përket dëmeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar, në dosje të tenderit është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre. O.E. ankues ka paraqitur një shumë enorme të shpenzimeve me qëllim të përfitimit të pa bazë dhe të pa drejtë. Andaj konsiderojmë se edhe ky pretendim është i pa bazë.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 20.04.2023

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.